

Qendra “Durrësi Aktiv”

1. Informacion Bazë

- Viti i Themelimit: 2019
- Statusi Ligjor: Qendër
- Selia Qendrore: Lagja nr.1, Rruga “Epikadeve”, Pallati 1047, Durrës.
- Faqja e Internetit: <https://durresiaktiv.al/>
- Email kryesor i organizatës: durresiaktiv@gmail.com
- Telefoni kryesor i organizatës: +355692936395

2. Misioni

Qëllimi ynë është përmirësimi i jetës së qytetarëve përmes ndryshimeve ekonomike, politike, mjedisore dhe sociale.

Ne po ndërmarrim hapa për të promovuar angazhimin qytetar dhe organizimin e komunitetit për të adresuar problemet e tyre dhe për të siguruar që zëri i qytetarëve të dëgjohet në vendimmarrjen lokale.

3. Vizioni (Opsionale)

Ne synojmë të mobilizojmë qytetarët për të marrë pjesë aktive në formësimin e realitetit tonë kolektiv.

4. Fushat Kryesore të Fokusit

- Organizim Komuniteti
- Ngritja e Kapaciteteve për angazhim qytetar
- Advokim për mjedisin
- Angazhimin e komunitetit në proceset vendim-marrëse
- Krijimin e urave bashkëpunuese midis qytetarëve dhe institucioneve të ndryshme.

5. Aktivitetet/Programet Kryesore

- Qytetarët e Durrësit aktorë dhe faktorë në vendimmarrjen lokale

Mbështetur nga: Leviz Albania

Kohëzgjatja: Maj 2020 – Maj 2021 Qëllimi: Adresimi tek pushteti vendor i problemit të derdhjes së ujërave të ndotura në kanalet e hapura (bujqësore) në zonën e ish-Kënetës, Shkozetit dhe Porto-Romanos, përmes aktivizmit qytetar dhe ndjekja e çështjes në rrugë ligjore.

Objektivat: Informimi mbi situatën përmes dokumentarëve investigativ që synojnë njohjen me nivelin e investimeve në rrjetin e kanalizimeve, impaktin në mjedis dhe shëndetin e qytetarëve;

Realizimi i një monitorimi dhe raporti shkencor të nivelit aktual të ndotjes në kanal, për të sjellë për herë të parë fakte dhe të dhëna konkrete. Adresimi i problemit dhe marrjen e masave për zgjidhje drejtuar pushtetit vendor nëpërmjet nxitjes së aktivizmit.

Rezultatet: Matja e nivelit të ndotjes dhe vlerësimi i ndikimit në shëndet e mjedis, sistemi i dikurshëm i kanalizimeve të zonës së ish-Kënetës në Durrës tashmë përdoret më së shumti si një sistem kanalizimesh të ujërave të përdorura nga zona urbane përreth, i cili duke mos përmbushur standardet e një sistemi kanalizimesh përbën kërcënim serioz për mjedisin dhe për shëndetin e komunitetit të zonës.. Rezultatet tregojnë për një ndotje të moderuar edhe të plazheve në veri dhe në jug të portit të ri të hidrokarbureve në zonën e Porto-Romanos.

- Angazhimi i vullnetarëve të rinj në aktivizimin e komunitetit dhe reagimit ndaj fatkeqësive

Mbështetur nga: UNDP Albania

Kohëzgjatja: Dhjetor 2021 – Qershor 2022

Qëllimi: Ngritja e Platformës së Vullnetarizmit në Komunitet në Bashkinë e Durrësit, për të mbështetur vullnetarizmin, për të nxitur transparencën, për të nxitur vendimmarrjen pjesëmarrëse në planifikim, për të gjeneruar të dhëna për vullnetarët që do të trajtojnë problemet e komuniteteve të tyre dhe do të ndërmarrin nisma rikuperimi në përballimin e pasojave të tërmetit dhe ndërtimit të së ardhmes së tyre. Objektivat:

Qendra “Durrësi Aktiv”

Ngritja e platformës së parë të vullnetarizmit në qytetin e Durrësit me qëllim angazhimit të vullnetarëve në komunitete, gjenerimi i të dhënave, fuqizimi i zërit të rinjve, ngritja e kapaciteteve në përballimin e fatkeqësive natyrore.

- Mbështetur nga: European Endowment for Democracy

Kohëzgjatja: Janar – Dhjetor 2023

Qëllimi: Të mbështesë aktivitetet e Durrësit Aktiv që po angazhojnë qytetarët dhe veçanërisht aktivistët e rinj në qytet në temat e angazhimit të komunitetit dhe qytetarit aktive.

Objektivat:

Identifikimi dhe priorizimi i nevojave të qytetarëve të Durrësit për terren dhe online nëpërmjet thirrjes për t'u bashkuar me Qendrën Durrësi Aktiv;

6. Shtrirja Gjeografike

Qendra Durrësi Aktiv ka bazën në qytetin e Durrësit dhe vepron në disa shtresa gjeografike:

Durrës (qyteti + zona përreth) – projekte mjedisore në lagjen Këneta dhe kanalet e saj, fushata për sigurinë e biçikletave në Shëtitoren “Taulantia”, si dhe veprimtari kulturore në monumente historike si Hamami dhe Kulla Veneciane.

Qarku Durrës – ndërhyrje në njësitë administrative Rrashbull, Katund i Ri dhe Manzë për edukim mjedisor, turizëm kulturor dhe përfshirjen e të rinjve.

Tiranë, Shkodër & Vlorë – partneritete periodike për trajnime, webinare dhe nisma kombëtare mbi transparencën publike dhe aktivizmin qytetar.

7. Udhëheqja

Drejtori Ekzekutiv/CEO: Klaudio Hyseni

Bordi i Drejtuesve: Klajdi Bido, Iva Hyseni, Klajdi Begeja (në largim)

8. Partneritetet dhe Bashkëpunimet (Opsionale)

- Bashkimi Evropian – përmes programeve EU4Culture, Erasmus+ & European Solidarity Corps, që financojnë ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe shkëmbimet e rinisë.
- UNOPS – mbështetje teknike e financiare në restaurimin e monumenteve dhe zhvillimin e projekteve komunitare.
- UNDP - kanë mbështetur disa herë qendrën për nisma të ndryshme për fuqizimin e komunitetit për reziliencën dhe aktivizimin ndaj fatkeqësive natyrore.
- Bashkia Durrës – bashkë-organizim aktivitetesh publike dhe lehtësim i nismave mjedisore e kulturore.

9. Ndikimi (Opsionale)

Rezultate të Matshme & Statistika Kryesore të Durrësi Aktiv (2019 – 2025).

6 500+ qytetarë të angazhuar në workshope, forume publike dhe fushata online/offline për mjedisin, transparencën dhe trashëgiminë kulturore.

320 vullnetarë të rinj të trajnuar në aktivizëm qytetar, monitorim buxhetor dhe menaxhim eventit (54% gra/vajza).

20 aksione pastrimi që kanë larguar 42 tonë mbetje urbane nga bregdeti dhe kanalet kulluese.

4.2 km korsi biçikletash të futura në planin urbanistik falë lobimit tonë të vazhdueshëm (2015 – 2024).

Rekomandime të pranuar nga Këshilli Bashkiak mbi buxhetimin e hapur, menaxhimin e ujërave të ndotura dhe transportin e qëndrueshëm.

Këto arritje konkrete tregojnë ndikimin tonë të drejtpërdrejtë në përfshirjen qytetare, përmirësimin e mjedisit dhe forcimin e trashëgimisë kulturore në Durrës dhe më gjerë.

10. Lajmet e Fundit/Çmimet (Opsionale)